REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI BASHKIAK TIRANË

V E N D I M

Nr.60, datë 08/11/2005

"MBI PAGESËN E TVSH-SË DHE TAKSËS DOGANORE PËR DY MAKINAT E PASTRIMIT, DHURATË NGA BASHKIA E ROMËS"

Në mbështetje të ligjit Nr.8652, dt.31/07/2000 "Për organizimin dhe funksionimin e qeverisjes vendore" neni 19, pika 9, neni 32, gërma "dh", ligjit Nr.7776, dt.22/12/1993 "Për buxhetin lokal", neni 18 dhe neni 21, ndryshuar me ligjin Nr.8399, dt.09/09/1998, Vendimit të Këshillit Bashkiak Nr.12, dt.21/03/2005 "Për miratimin e realizimit të buxhetit për vitin 2004 dhe detajimin e buxhetit të Bashkisë së Tiranës për vitit 2005", bazuar në marrëveshjen me Bashkinë e Romës me propozim të Kryetarit të Bashkisë së Tiranës, Këshilli Bashkiak,

V E N D O S I;

1. Të miratojë përdorimin e fondit të investimeve në shumën 469.605 lekësh për Drejtorinë e Përgjithshme Nr.1 të Punëtorëve të Qytetit, për "Pagesë TVSH-je dhe Taksës Doganore" për mjetet dhuratë nga Bashkia e Romës, të përcaktuara sipas listës bashkëlidhur.

2. Efektet financiare të pikës 1 të këtij Vendimi të përballohen nga fondet e investimeve për Drejtorinë e Përgjithshme Nr.1 të Punëtorëve të Qytetit, të mbetura në zërin "Pagesë TVSH-je dhe spedicion për mjetet dhuratë nga Qeveria Kineze".

3. Drejtoria e Përgjithshme Nr.1 e Punëtorëve të Qytetit në zbatim të legjislacionit në fuqi, të kryejë të gjitha proçedurat e pagesës, zhdoganimit dhe përfshirjes së këtyre mjeteve në inventarin ekonomik të saj.

4. Për zbatimin e këtij Vendimi ngarkohen Drejtoria e Përgjithshme e Punëve Publike dhe Drejtoria e Përgjithshme Nr.1 e Punëtorëve të Qytetit.

5. Ky Vendim hyn në fuqi 10 ditë pas shpalljes.

K R Y E T A R I

LUAN SHAHOLLARI